



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	10.4.2011
PËR/ZA/TO:	KPF-Asamblenë Komunale
PËRMES	Kryetari i KK Vushtrri z. Bajram Mulaku
NGA/OD/FROM:	Drejtor i BTHF z.Isuf Jashari _____
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me realizimin e buxhetit janar-mars/2011,dhe inkasimin e të hyrave vetjake për muajin janar-mars/2011

Duke u bazuar në nenin 62, paragrafi 62.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 45 të Ligjit nr.03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, dhe neni 75 të Statutit të Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ofron informatën e punës për muajin Janar-Mars/2011 .

Buxheti i Komunës është përgatit në afatin e paraparë ligjor dhe është dërguar në MEF.

Mirëpo, për shkak të zgjedhjeve të nivelit qendror aprovimi dhe miratimi i tij nga legjislacioni i Kosovës është bërë me vonesë shumë të madhe dhe si rrjedhojë e sajë është vonuar alokimi i mjeteve buxhetore nëpër të gjitha organizatat buxhetore të Kosovës.

Pjesa e buxhetit të alokuar për majin janar – mars/2011 është bërë në suaza të ligjit të buxhetit e alokuar (1/12)për tremujorin e parë. Ky alokim ka të bëjë vetëm për kategorinë e pagave dhe shtesave , kategorinë e mallrave dhe shërbimeve , shpenzimet komunale dhe subvencioneve.

Kategoria e investimeve kapitale është alokuar në muajin prill në bazë të Planit të rrjedhës së parasë nga Komuna, andaj kërkohet një angazhim më i shtuar në përgatitjet e materialit të nevojshëm me qëllim të publikimit dhe fillimit të procedurave të prokurimit me qëllim të realizimit të këtyre projekteve në afatin e paraparë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa çdo fillim të viti bënë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit financiar duke pasur parasysh rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Drejtoria ka përgatit pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2011 dhe në afatin e paraparë ligjor janë dorëzuar në MEF.

Është përgatit rrjedha e parasë për të gjitha programet buxhetore dhe është dorëzuar Departamentit të Thesarit në MEF.

Nga zyrtari i të hyrave komunale janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për të hyrat vetjake të vitit 2010 dhe bartjen e të hyrave të pashpenzuara në vitin 2011.

Në vazhdim po e pasqyrojmë Tabelën e mjeteve të alokuara për periudhën janar-mars/2011, duke pasur parasysh se gjatë këtij tremujori janë flokuar mjetet e grandit qeveritar, fondi(10), dhe mjetet nga donatoret, fondi (31).

Fondet e Buxhetit komunal

Fondi 10 – (Garanti Qeveritar).

Fondi 31 – (Donacionet e jashtme, participimet).

Të hyrat nga Garanti Qeveritar:

Fondi 10

Realizimi i këtyre mjeteve sipas kategorive ekonomike është i dhënë në tabelën në vijim.

Fondi 10					
Njësia	Buxheti I				
Buxhetore	Planifikuar	ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA
	Janar-Mars/11	Janar-Mars/11	Janar-Mars/11	Janar-Mars/11	Janar-Mars/11
Pagat	1,735,400.99	1,735,400.99	887,399.02	-	848,001.97
Mallrat & Shërbimet	244,077.00	244,077.00	118,491.70	38,013.13	87,572.17
Komunalit	55,803.00	55,724.01	51,407.12	355.15	4,040.73
Investime kapitale(donacionet)	77,238.00	77,238.30	-	-	77,238.30
Sumbencione dhe transfere	12,500.00	12,500.00	12,450.00	-	50.00
Totali	2,125,019.29	2,124,940.30	1,069,747.84	38,368.28	1,016,903.17

Siç po shihet nga tabela:

- Mjete të planifikuara për paga janë: 1,735,400.99€, të alokuara 1,735,400.99€, të realizuara 887,399.02€, mjete të lira 848,001.97€.
- Mjete të planifikuara për mallra dhe shërbime janë: 189,508.00€, të alokuara 189,508.00€, të zotuar 38,013.13€, të shpenzuara 118,491.70€, të lira 33,003.17€.
- Mjete të planifikuara për komunalitet janë: 55,803.00€, të alokuara 55,724.01€, të zotuar 355.15€, të shpenzuara 51,407.12€, mjete të lira janë 4,040.73€.
- Shpenzimet kapitale të paraqitura në tabelë janë mjete të financuar nga donatorët deri sa mjetet për këtë kategori nga Fondi 10 dhe 21 nuk janë floguar.
- Subvencione dhe transfero, të planifikuara 12,500.00€, të alokuara 12,500.00€, të shpenzuara 12,450.00€, të mbetura 50.00€.

Nga gjithsej shuma e mjeteve buxhetore të Komunës në shumë prej 12,483,567.00€ janë alokuar vetëm 2,124,940.30€, sipas kategorive ekonomike të cekura më sipër.

Buxheti ka përgatit bartjen e të hyrave nga viti paraprak dhe pritet alokimi i tyre në afatin sa më të shpejt me qëllim të financimit të projekteve të papërfunduara nga viti i kaluar.

Te hyrat vetjake për muajin Janar-Mars 2011

Për periudhën Janar-mars 2011 bazuar në buxhetin komuna nga të hyrat vetjake ishin planifikuara të inkasohen 328,750.00€ nga të gjitha burimet. Dhe për këtë periudhë janë inkasuar 283,864.32€ ose 86.35% nga planifikimi, mirëpo krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak, ku ishin inkasuar 222,223.62€, inkasomi i të hyrave është më i madhe për 27.74%.

Sektori i tatimit në pronë:

- Edhe në këtë vit shpërndarja e faturave për vitin 2011 është bërë nga Posta dhe shpërndarja është kryer në afatin e paraparë.
- Kemi bërë regjistrimin e 107 objekteve të reja të cilat janë futur në sistem dhe janë faturuar.
- Gjatë këtij viti kemi aplikuar ri programimin e borxhit me qëllim të lehtësimit të pagesës së obliguesve tatimorë.
- Në vijim paraqesim tabelën e planifikimit dhe realizimit të tatimit në pronë për muajin janar- mars/2011 .

1	Planifikimi për muajin	Realizimi për muajin	Realizimi për muajin	INDEKSAT	
	Janar-Mars/11	Janar-Mars/10	Janar-Mars/11	4:2	4:3
Tatimi në pronë	50,000.00€	57,149.98€	74,769.60€	149.54	130.83

Të hyrat e planifikuara në tatim pronë janë 50,000,00€,të realizuara 74,769.60€,indeksi 149.54,krahasuar me vitin paraprak të hyrat nga tatimi në pronë janë më të mëdha për 30.83%.

Spektori i Financave publike:

- Në fillim të vitit 2011,janë përgatit 980 aktvendimet mbi ngarkesën e taksës komunale dhe janë shpërndarë obliguesve të taksës në firmë.
- Për një pasqyrim më të mirë të inkasimit të taksës komunale po e japim tabelën në vijim:

	Planifikimi për muajin Janar-Mars/11	Realizimi për muajin Janar-Mars/10	Realizimi për muajin Janar-Mars/11	INDEKSAT	
1	2	3	4	4:2	4:3
Taksa në Firmë	35,125.00€	44,667.97€	45,077.74€	128.34	100.92

Të hyrat për taksën në firmë janë planifikuar 35,125.00€,të realizuara 45,077.74€ indeksi 128.34,ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar inkasimi i të hyrave në këtë tremujor është përafërsisht i njëjtë me një tendencë të rritjes.

Shtojcë :

- Pasqyrat e të hyrave vetjake TABELA nr.1.